

**MIRATOHET
BASHKIA HAS
KRYETARI
Z. Miftar DAUTI**

DETYRË PROJEKTIMI

OBJEKTI: “ PROJEKTIMI I RRUGËS KRUMË-CAHAN-POGAJ ”.

POROSITESI: BASHKIA HAS.

VENDNDODHJA: NJ. ADM. KRUMË

HYRJE:

Zona në të cilën do të ndërtohet kjo rrugë i përket Bashkisë së Hasit, qender e së cilës është qyteti i Krumës, në qarkun e Kukës. Ai është qyteti i tretë më i madh në këtë Qark pas Kukës dhe Tropojës, për nga numri i banorëve sipas Regjistrimit të Gjendjes Civile, që i përket zonës së Shqipërisë Verilindore.

Në këtë zonë mbizotëron përgjithësisht një terren kodrinor–malor, i karakterizuar nga reliev i thyer dhe lartësi të ndryshme.

Klima është mesdhetare kontinentale, me dimra të ftohtë dhe me reshje të konsiderueshme, ku temperaturat mund të zbresin deri në rreth -5°C , ndërsa vera është e ngrohtë dhe e thatë. Temperatura mesatare vjetore luhet rreth $14-18^{\circ}\text{C}$.

Qyteti i Krumës bën pjesë në Bashkinë Has, e cila sipas ndarjes territoriale të vitit 2015 përbëhet nga disa njësi administrative dhe shtrihet në një sipërfaqe prej rreth 374 km^2 .

OBJEKTIVI:

Objektivi i detyrës së projektimit është hartimi i Projektit të Zbatimit dhe realizimi i një investimi me infrastrukturë bashkëkohore, për këtë objekt:

- **“Rikonstruksioni i Rrugës “KRUMË-CAHAN-POGAJ”.**

QELLIMI I PUNES:

Për realizimin e projektit, projektuesi duhet të rishikojë të gjithë informacionin ekzistues lidhur me terrenin ku shtrihet gjurma e objektit, duke zbatuar me perpikmeri detyrën e projektimit, si dhe vazhdimisht të konsultohet me specialistet e zyrës së urbanistikës pranë Bashkisë Has.

Cilesia e studimit – projektimit duhet të jetë e tillë që të arrihet standarti i kërkuar dhe të zbatohen kushtet teknike shqiptare të projektimit.

PERSHKRIMI I SHKURTER I GJENDJES EKZISTUESE PËR OBJEKTIN:

- **“Rikonstruksioni i Rrugës “KRUMË-CAHAN-POGAJ”.**

Gjatësia totale e rrugës shkon 16.44 km .

Aksi kryesor i rrugës ka patur ndërhyrje të pjesshme përgjatë kohës, ku sipërfaqja e rrugës është trajtuar me cakell, dhe që e cila aktualisht ndodhet në gjendje të amortizuar. Përgjatë rrugës ka disa vepra arti si tombino dhe mure mbajtëse, por që në këtë projekt ide parashikohet të ketë ndërhyrje për permiresimin dhe rritjen e sigurisë së tyre për kullimit të ujërave atmosferike dhe qëndrueshmërisë së skarpave. Në kahun e majtë të aksit kryesor të rrugës parashikohet ndërtimi i një kanali të hapur prej dheu, dhe në raste të vecanta ku formacionet do të jenë të dobëta, kanali do të jetë prej betoni. Këto kanale do të orientohen drejt tombinave.

Qëllimi kryesor i ndërtimit të këtij segmenti rrugor është lidhja e fshatrave të Hasit si një enderr e krahut dhe popullsisë së asaj krahine të ndare padrejtesisht në 2 shtete. Kjo rrugë do të rrisë komunikimin dhe lëvizjen e banorëve të kësaj ane, si dhe zhvillimin e turizmit të zonës duke qenë se kalon rreze malit të Pashtrikut, ku poshtë tij shtrihet lugina e Drinit të Bardhë dhe Liqeni i Fierzës.

Koordinatat gjeografike sipas sistemit KRGJSH:

Qyteti i Krumës FILLIMI I RRUGES: x = 534316.250 dhe y = 4673624.306
Fshati Pogaj MBARIMI I RRUGES: x = 543731.542 dhe y = 4670934.065

Vlera e perafert e ndertimit te objektit: 1,000,000,000.0 (nje miliarde) leke me T.V.SH



Fig. 1 – Vendodhja e objektit sipas Ortofotos nga GOOGLE EARTH.

TE DHENAT PER REALIZIMIN E PROJEKTEVE NE UJESJELLESA:

1. Gjatësia totale e rruges është rreth 16.44 km.
2. Gjerësia e rruges propozohet të jetë 5.5 m e asfaltuar me një pjerresi, si dhe me bankina anësore 2x0.5m, pra gjerësia totale do të jete minimumi 6.5 m.
3. Shtresat rrugore të trajtohen të tilla që të sigurojnë garanci, qëndrueshmëri dhe të përballojnë kapacitetet faktike dhe të prespektivës.
4. Në pika të vecanta duhet të përcaktohen edhe vende për ndërim mjetesh.
5. Sistemi i rrjetit të kanalizimeve të ujrave të bardha në të gjithë gjatësinë e rrugës, duke pare mundësinë e realizimit të kanaleve prej betoni ose të hapur natyrale, bankina ose kuneta, portale dhe kalime me tub çeliku ose HDPE, tombino etj.
6. Referuar skarpatave të rrugës, të përdoren mure ose bordura prej betoni.
7. Degëzimet ose kryqëzimet e kësaj rruge të trajtohen të paktën deri 5 m gjatësi.
8. Sinjalistika do të përfshijë atë vertikale dhe horizontale. Për sinjalistikën horizontale do të përdoren vijëzimet gjatësore dhe kalime këmbësorësh. Ndërsa për sinjalistikën vertikale të përdoren tabela rrugore si dhe tabela me emërtimet e rrugëve.
Gjithashtu, nëse do të jetë e nevojshme për sigurinë rrugore do të përdoret dhe guardrail.
9. Projektuesi duhet të përdorë dhe të rishikojë të gjithë informacionin ekzistues lidhur me rrugën. Gjithashtu, në hartimin e projektit duhet të kihen parasysh edhe standarte të ndryshme që ka përcaktuar Ministria e Infrastrukturës.

Projektuesi duhet të përdorë dhe të rishikojë të gjithë informacionin ekzistues lidhur me OBJEKTIN. Gjithashtu, në hartimin e projektit duhet të kihet parasysh edhe standarte të ndryshme që ka përcaktuar Ministria e Infrastruktura – AKUK.

KERKESAT QE DUHET TE ZGJIDHE PROJEKTI:

1. Hoorografia ose Planvendosja, ne shkalle 1:5000 ose 1:10000.
2. Hartimi I relievit topografik (koordinata locale,kuota absolute), shkalle 1:1000 ose 1:500.
3. Përcaktimin e aksit me elementet gjeometrike 1:1000 ose 1:500.
4. Planimetrinë e objektit në shkallë 1:1000 ose 1:500.
5. Profili gjatësor në shkallë 1:1000 ose 1:500.
6. Profilet terthore dhe Profilet TIP në shkallë 1:50 ose 1:100.
7. Planimetri dhe detaje për lëvizshmëri/sinjalistikë rrugore (vertikale dhe horizontale).
8. Planimetrinë për rrjetin e kanalizimeve të ujrave të bardha, si dhe detaje e prerje të kanaleve, tombinove, portaleve etj.
9. Projekti dhe llogaritjet përkatëse mbi veprat e artit nëse ka.
10. Detaje të ndryshme (bordura, kanale, shtresa rrugore, tombino, mure pritëse dhe mbajtëse, barriera mbrojtëse sinjalistika .
11. Kryqëzimet dhe detaje përkatëse, si dhe vendndërimet e mjeteve.
12. Raporti teknik mbi zgjidhjen e dhënë.
13. Specifikimet teknike të zbatimit të projektit.
14. Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM).
15. Relacionet perkatëse topografike, gjeologjike, hidrogeologjike etj.
16. Grafiku i punimeve.
17. Preventivi i punimeve mbështetur ne çmimet e VKM nr. 216, date 13.4.2023, si dhe analizat teknike perkatëse per zerat e paparashikuara ne kete VKM.
18. Të gjitha fletët e vizatimeve teknike duhet të jenë të detajuara me elementët përkatës, si dhe legjendat përkatëse.

Shënim: Nëse shkallët e mësipërme nuk janë të lexueshme të ndryshohen, si dhe të shtohet cdo lloj dokumenti tjetër i mundshëm që mund të gjykohet i nevojshëm nga Projektuesi për plotësimin e kërkesave që do t'i japin zgjidhje përfundimtare investimit të lartpërmendur. Gjithashtu, të kihet parasysh dhe të përgatitet i gjithë dokumentacioni ligjor dhe teknik i projektit për realizimin e Oponencës Teknike dhe aplikimin për Leje Infrastruktura ne e-Leje.

Hartimi i Preventivit Përfundimtar:

Për hartimin e preventivit projektuesi duhet të mbështetet në VKM nr. 216, date 13.4.2023 “Per krijimin dhe funksionimin e sistemit te integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”.

Për secilin zë punimi, i cili nuk është i përfshirë në këtë manual, projektuesi duhet të dorëzojë analizat/ofertat përkatëse të çmimeve.

Në hartimin e preventivit, veç të tjerave do të mbahen parasysh sa më lart, lidhur me organizmin e zbatimit me faza, çmimet e referencës sipas akteve ligjore në fuqi, si dhe llogaritja e preventivit do të bëhet sipas normave dhe akteve ligjore në fuqi për të siguruar kursimin dhe efikasitetin e përdorimit të fondeve.

Preventivi do të hartohet sipas formatit/modelit standart të rekomanduar sipas VKM në fuqi.

Fazat e projektimit për këtë objekt sipas VKM nr. 354, datë 11.05.2016 janë:

- **Projekt ideja paraprake**
Paraqitja e projekt idese paraprake per rekomandime dhe sugjerime nga Autoriteti Kontraktor.
- **Projekt ideja perfundimtare**
Paraqitja e projekt idese perfundimtare pasi jane zbatuar rekomandimet dhe sugjerimet e specialisteve perkates te Autoritetit Kontraktor.
- **Projekti per miratimin e Lejes se Ndertimit**
Pergatitja e projektit dhe dokumentacionit qe kerkohet per pajisjen me Leje Ndertimi, si dhe te garantoje disponimin e aplikimit per Leje ne sistemin elektronik ne momentin qe do t'i kerkohet nga Autoriteti Kontraktor.
- **Projekti i Zbatimit**
Perpunimi dhe paraqitja e projektit me zgjidhje perfundimtare per zbatim.
- **Preventivi Përfundimtar**
Preventivi perfundimtar te perfshije te gjitha proceset e punimeve te ndertimit.

Standarte në Projektim:

Projekti do të hartohet në përputhje me të gjitha normat dhe standartet për projektim që parashikon legjislacioni shqiptare në fuqi. Projektimi duhet të sigurojë respektimin e standarteve, madje edhe atyre gjate zbatimit.

Eshtë përgjegjësi e Projektuesit saktësia dhe respektimi i të gjitha standarteve dhe normave përkatëse.

Projektuesi mund të rekomandojë edhe prezantimin e standarteve të reja, për përafrimin me normat e BE-se, si dhe të praktikave më të mira ndërkombëtare në projektim dhe zbatim. Rekomandimet duhet të përmbajnë elemente të fizibilitetit dhe realizueshmërisë me praktikën shqiptare dhe limitimet për financimin e veprës.

Standarte në paraqitjen e dokumentacionit teknik:

Në hartimin dhe paraqitjen e dokumentacionit të projektit, Projektuesi të përdorë programet e kërkuara kompjuterike, si dhe të nxitet përdorimi i programeve të reja e me të avancuara të fushës.

Në hartimin, paraqitjen dhe miratimin e dokumentacionit teknik të projektit të kihen parasysh dhe të respektohen të gjitha kërkesat dokumentare dhe të paraqitjes që parashikon ligji per planifikimin e territorit dhe kushtet teknike shqiptare te projektimit.

1. **Preventivi me çmime** njësi te aprovuara me VKM në fuqi, si dhe në bazë të analizave të çmimeve për zërat qe mungojnë.
2. **Fondi rezervë 1-5 %.**
3. **Preventivi pa çmime.**
4. **Grafiku i punimeve.**
5. **Raportet teknike perkatese.**
6. **Specifikimet teknike.**

7. Projekti i plote i zbatimit.

Projekti do te paraqitet në formë grafike në 3 kopje origjinale, gjithashtu dhe në CD ne format soft copy AutoCad, Excel, word, si dhe i skanuar ne PDF.

Projektuesi gjate hartimit te projekt – zbatimit duhet të bashkëpunojë ngushtë me Autoritetin Kontraktor, si dhe të japë zgjidhje teknike të projektit për të gjitha fazat dhe kërkesat e detyrës së projektimit.

Stafi për Projektim:

PROJEKTUES KONSTRUKTOR (Inxhinier Hidroteknik/ Inxhinier Ndertimi):

Kat. 6 a) – Projektim rruge lokale, rruge urbane dytesore dhe rruge interurbane dytesore.

Kat. 7 a) –Projektim ura dhe vepra arti të vogla deri më 10 m.

Kat. 11 a) – Projektim sinjalistikë jondriçuese në rrugë lokale, rrugë urbane dytësore, rrugë interurbane dytësore, sheshe e parkime.

PROJEKTUES VEPRA HIDRAULIKE (inxh. Hidroteknik):

Kat. 5 c) – Projektim Ujësjiellës-kanalizime urbane - rurale.

Kat. 5 d) – Projektim Vepra ujitje-kullimi-tombino etj.

PROJEKTUES GJEODET (inxh. Topograf / Gjeodet / Markshajder):

Kat. 8 a) – Rilevime inxhinierike.

Kat. 8 d) – Bazamente gjeodezike.

Kat. 8 e) – Projektim fotogrametrik dhe hartografik.

PROJEKTUES PER RRUGE (inxh. Ndertimi – Profili Infrastruktore):

Kat. 6 a) – Projektim rruge lokale, rruge urbane dytesore dhe rruge interurbane dytesore.

Kat. 11 a) – Projektim sinjalistikë jondriçuese në rrugë lokale, rrugë urbane dytësore, rrugë interurbane dytësore, sheshe e parkime.

Kat. 12 c) – Studime/vlerësime të sizmologjisë inxhinierike për trojet ku ndertohen objekte te infrastruktures rrugore te te gjitha llojeve, ura etj

PROJEKTUES GJEOLOG (inxh. Gjeolog):

Kat. 9 d) – Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i trojeve të buta dhe shpateve me qëndrueshmëri të ulët.

Kat. 12 c) – Studime/vlerësime të sizmologjisë inxhinierike për trojet ku ndertohen objekte te infrastruktures rrugore te te gjitha llojeve, ura etj

PROJEKTUES VNM (inxh. Mjedisi ose 1 punonjes te pajisur me çertifikate):

Hartimin e raportit të Vlerësimi i Ndikimit ne Mjedis (VNM)

Përgatiti: ZYRA E URBANISTIKËS